

## Deklarata e privatësisë

### Deklarata për partnerin e autorizuar

Firma "Liebherr- Hausgeräte Marica" EOOD është një kompani, e cila synon të punojë në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore. Ne u kushtojmë rëndësi të madhe mbrojtjes dhe sigurisë së të dhënave Tuaja personale. Prandaj, është e rëndësishme që ne t'Ju informojmë se cilat të dhëna personale përpunojmë, për çfarë qëllimi dhe çfarë të drejtash keni në lidhje me të dhënat Tuaja personale.

#### A. Dispozita të përgjithshme

##### I. Çfarë janë të dhënat personale dhe çfarë do të thotë përpunim?

- Të dhënat personale (më poshtë të quajtura si "të dhënat") është çdo informacion me të cilin mund të identifikohet një person fizik. Të dhënat personale nuk janë vetëm informacioni me të cilin identifikohet drejtpërdrejt një person (si p.sh. emri ose adresa elektronike), por edhe informacioni përmes të cilit në mënyrë indirekte, përmes njohurive shtesë të disponueshme, mund të identifikohet një personi i caktuar.
- "Përpunim" nënkupton të gjitha operacionet që mund të kryhen me të dhënat Tuaja personale (si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përdorimi ose fshirja e të dhënave).

##### II. Kush mban përgjegjësi për përpunimin e të dhënave Tuaja personale?

Administratori i të dhënave Tuaja personale është:

"Liebherr- Hausgeräte Marica" EOOD,  
4202 Radinovo, bashkia Marica, qarku Plovdiv  
Tel.:00359/32-50-5309  
E-mail: [dataprotection.bg@liebherr.com](mailto:dataprotection.bg@liebherr.com)

##### III. Çfarë janë të drejtat Tuaja si subjekt i të dhënave?

Brenda kuadrit ligjor si subjekt i të dhënave, Ju keni të drejtë për:

- Informacion/akses në të dhënat Tuaja;
- Korrigjim të të dhënave të pavërteta dhe plotësim të të dhënave të paplota;
- Fshirje të të dhënave Tuaja, veçanërisht kur (1) ato tashmë nuk janë të nevojshme për qëllimet e treguara në këtë deklaratë të privatësisë, (2) Ju keni tërhequr pëlqimin Tuaj dhe mungon arsye tjetër ligjore për përpunimin, (3) të dhënat Tuaja janë përpunuar në mënyrë të paligjshme ose (4) Ju keni kundërshtuar përpunimin dhe nuk ekzistojnë arsye ligjore bindëse për përpunimin, të cilat të kenë përparësi.

- Kufizim të përpunimit të të dhënave Tuaja, veçanërisht kur saktësia e tyre kundërshtohet nga Ju ose përpunimi i të dhënave Tuaja është i paligjshëm, por Ju keni kërkuar kufizim të përdorimit të të dhënave në vend të fshirjes së tyre.
- Kundërshtim për përpunimin e të dhënave Tuaja, bazuar në një interes legjitim për arsye që rrjedhin nga veçantia e situatës Suaj konkrete ose - pa arsyetim të veçantë - kur përpunohen të dhëna personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë; nëse nuk ka një kundërshtim ndaj të dhënave të përpunuara për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, Ju lutemi tregoni arsyet e kundërshtimit, pse ne nuk mund të përpunojmë të dhënat Tuaja personale ose përkatësisht ne nuk mund t'i përpunojmë në këtë mënyrë. Në rast kundërshtimi të arsyetuar ne verifikojmë çështjen dhe ndalojmë përpunimin e të dhënave, përveç nëse vërtetojmë se ka baza ligjore bindëse për përpunimin që tejkalojnë interesat, të drejtat dhe liritë Tuaja, ose përpunimi shërben për konstatimin, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve të ligjshme.
- Marrje të të dhënave në një format të strukturuar, të aksesueshëm, të lexueshëm nga makina, si dhe transferim të të dhënave Tuaja nga ne direkt te një administrator tjetër.
- Tërheqje të pëlqimit Tuaj për përpunim, nëse na keni dhënë një të tillë. Ju lutemi, kini parasysh se ligjshmëria e përpunimit bazuar në pëlqimin Tuaj deri në momentin e tërheqjes së tij mbetet e paprekur nga tërheqja Juaj.

Në paraqitjen e pretendimeve në lidhje me të drejtat e mësipërme, Ju lutemi për mirëkuptim nga ana Juaj që eventualisht do të kërkojmë prova nga Ju të cilat të konfirmojnë se Ju jeni personi, për të cilin prezantoheni.

Gjithashtu, ju keni të drejtë të bëni ankesë pranë autoritetit mbikëqyrës kompetent nëse konsideroni se përpunimi i të dhënave Tuaja personale shkel kërkesat e Rregullores (BE) 2016/679 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lidhur me lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla.

## **B. Përpunimi i të dhënave**

### **I. Formulari i aplikimit - partner i autorizuar i Liebherr**

Kur paraqitet një aplikim duke plotësuar formularin online ne përpunojmë të dhënat personale të renditura më poshtë.

### **Çfarë të dhënash personale përpunojmë ne dhe për çfarë qëllimesh?**

Ne përpunojmë këto të dhëna Tuaja personale:

- Emri dhe mbiemri;
- Firma;
- Adresa ( rrugë, numër, kod postar, vendbanim, shtet).
- Numri i telefonit
- Adresa e-mail

Të dhënat e sipërme përpunojmë vetëm për qëllimin e pranimit dhe përpunimit të deklaratës Suaj.

Përpunimi i të dhënave për qëllime të tjera mund të bëhet vetëm, nëse janë të respektuara kërkesat e nevojshme ligjore në bazë të nenit 6, parg. 4 të Rregullores (BE) 2016/679. Në këtë

rast, kuptohet, ne do të respektojmë të gjitha detyrimet për ofrimin e informacionit në bazë të nenit 13, paragrafi 3 të Rregullores (BE) 2016/679 dhe nenit 14, paragrafi 4 të Rregullores (BE) 2016/679.

## ***Mbi çfarë baze ligjore përpunojmë të dhënat Tuaja personale?***

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave Tuaja është zbatimi i kontratës/ndërmarrja e hapave përpara lidhjes së kontratës në bazë të nenit 6, paragrafi 1, germa "b" të Rregullores (BE) 2016/679.

## ***II. Kategoritë e marrësve***

Ne do të dorëzojmë të dhënat Tuaja eventualisht tek:

1. Kompanitë e tjera të grupit të kompanive Liebherr, për aq sa kjo është e nevojshme për lidhjen, përmbushjen ose përfundimin e një kontrate ose nëse ka një interes legjitim nga ana jonë për këtë dorëzim dhe nuk ka asnjë interes legjitim të kundërt nga ana Juaj që do të kishte përparësi;
2. Ofruesit tanë të shërbimeve që ne përdorim për të arritur qëllimet e mësipërme;
3. Gjykatat, gjykatat e arbitrazhit, institucionet ose avokatët, nëse kjo kërkohet për respektimin e legjislacionit në fuqi ose për parashtrimin, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.

## ***III. Transferimi i të dhënave në shtete të treta***

Transferimi i të dhënave tek institucionet në vendet jashtë Bashkimit Evropian, përkatësisht Zona ekonomike evropiane (të ashtuquajturat vende të treta) ose organizatat ndërkombëtare lejohen vetëm (1) nëse na keni dhënë pëlqimin Tuaj ose (2) nëse Komisioni Evropian ka vendosur që ekziston një nivel adekuat të mbrojtjes së të dhënave në shtetin e tretë (neni 45 i Rregullores (BE) 2016/679). Nëse Komisioni nuk ka marrë një vendim të tillë, ne do të jemi në gjendje t'i transferojmë të dhënat Tuaja vetëm tek subjektet e jashtme të vendosura në shtetet e treta, me kusht se ekzistojnë garanci të përshtatshme (p.sh. klauzola standarde për mbrojtjen e të dhënave, të miratuara nga Komisioni ose autoriteti mbikëqyrës në procedurën konkrete) dhe se të drejtat Tuaja janë të garantuara, respekt. transferimi i të dhënave është i lejueshëm në rastin konkret bazuar në derogimet e përcaktuara në nenin 49 të Rregullores (BE) 2016/679.

Nëse transferojmë të dhënat Tuaja personale tek shtetet e treta, ne do t'ju njoftojmë për detajet e transferimit në vendet e përshtatshme të kësaj deklarate të privatësisë.

## ***IV. Afati i ruajtjes dhe fshirjes së të dhënave***

Ne përpunojmë të dhënat Tuaja për aq kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit përkatës, përveç nëse Ju e keni kundërshtuar në mënyrë efektive përpunimin e të dhënave Tuaja ose e keni tërhequr efektivisht pëlqimin Tuaj.

Nëse ekzistojnë detyrime ligjore për ruajtjen e të dhënave, ne do të duhet të ruajmë të dhënat përkatëse brenda afatit të detyrueshëm. Pas skadimit të këtij afati ne kontrollojmë nëse ka ende nevojë për përpunim. Nëse nuk ekziston më një nevojë e tillë, të dhënat Tuaja do të fshihen.

## ***V. Marrja e automatizuar e vendimeve individuale***

# LIEBHERR

Kur vendosim dhe realizojmë marrëdhënie të biznesit ne nuk aplikojmë vendimmarrje të bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar në përputhje me nenin 22 të Rregullores (BE) 2016/679. Nëse në raste të veçanta përdorimi i procedurave të tilla bëhet i nevojshëm, ne informojmë për këtë veçmas në këtë deklaratë, për aq sa kjo parashikohet në ligj.

## ***VI. Mbrojtja e të dhënave Tuaja personale nga aksesit i paautorizuar dhe humbja***

Ne përdorim masa teknike dhe organizative të sigurisë, për të garantuar se të dhënat Tuaja janë të mbrojtura nga humbja, ndryshimi ose aksesit i paautorizuar nga palët e treta. Në çdo rast aksesit në të dhënat Tuaja nga ana jonë kanë vetëm personat e autorizuar dhe vetëm në masën që është e nevojshme për qëllimet e përmendura më sipër.

*Shtator 2024*